Mësimi 9
Jozefi Tregon Veten

Qëllimi
Studjoni Zanafilla 45, Jozefi u tregon identitetin e tij vëllezërve të tij. Mësoni se mund të falim dhe se njerëzit në jetën tonë mund të ndryshojnë dhe të maturohen.

Materialet
Mësuesja dhe/ose Koordinatorët sigurojnë që materialet të jenë gati para çdo ore mësimore.

Printoni nga Faqja e Internetit:
- Jozefi Tregon Veten – një për nxënës
- Ndihma Vizive Jozefi Tregon Veten – një për klasën
- Bibla – të mjaftueshme që secili të ketë një
- Stilolapsa/Lapsa/Krejona
- Stikera (për regjistrimin e pjesëmarrjes)
- Grafiku i Pjesëmarrjes

Materiale Opsionale
- Snack: Fruta ose djathë në formë zemre – të mjaftueshme për të gjithë
- Fasha – 1-2 për nxënës

Mësimi i Objektit të Faljes – të krijohet gjatë orës mësimore jo më parë
- Qese zip – qese për sanduiç që mbyllet – një për mësuesen
- Ujë i Ngrohtë – ¼ e kupës
- Uthull – ½ e kupës
- Sodë Buke – 3 lugë kafeje
- Mjete të matjes për të matur lëngje dhe sodën e bukës
- Kleenex – 1
- Tabaka për të shmangur ndotjen e tryezës
- Peshqir letre ose peceta në rast të derdhjeve

Këshilla për Mësuesen
★ Shikoni Mësimin 1 për ide

1) Hyrja në Mësim

Ndërsa nxënësit hyjnë, mirëpritini. Falënderojini që kanë ardhur. Regjistroni prezencën.

Çfarë studjuam javën e kaluar rreth Jozefit? Jozefi vuri në provë vëllezërit e tij duke vendosur një kupë prej argjëndi në trastën e Beniaminit për të parë se si do të reagonin vëllezërit. Ata të gjithë u bënë bashkë në ndihmë të Beniaminit duke shpresuar se Jozefi do t'a lironte atë pasi u kap me kupën e vjedhur. Vëllezërit e Jozefit kishin mësuar të bënin gjënë e duhur dhe të mos ishin më xhelozë të vëllezërve të tyre më të vegjël.

Nëse dikush bëri diçka të gabuar ndaj jush dhe patët një rast për t'ua kthyer dhe për të kërkuar hakmarrje, a do t'a bënit këtë? Lejoni që nxënësit të përgjigjen.

Shumë njerëz duan hakmarrje, por çfarë thotë Bibla? Le të dëgjojmë se si reagoi Jozefi ndaj vëllezërve të tij pasi u vunë në provë nga ai. Ai pati një rast të hakmerrej ndaj vëllezërve të tij. Çfarë mendoni se do të bëjë? Mendoni rreth saj ndërsa lexojmë historinë.

2) Koha e Mësimit – Jozefi Tregon Veten 15-20 minuta

Jepuni Bibla dhe kini gati ndihmën vizive.

Nxënësit le të shkojnë tek **Zanafilla 45**.

Lexoni ose kërkoni që dikush të lexojë **Zanafilla 45:1-15** dhe tregoni ndihmën vizive.



Josefi i fali vëllezërit e tij që e shitën në skllavëri. Jozefi pati një rrugë të gjatë të mbushur me sfida, por e mbajti besimin e tij tek Perëndia. Në vend që të zemërohej, Jozefi mbajti mend se si Perëndia kishte një qëllim për gjithshka që ndodhi. Ai zgjodhi të falë vëllezërit e tij në vend që të kërkonte hakmarrje. Kjo na mëson se edhe kur njerëzit na lëndojnë, mund t'i falim dhe të heqim dorë nga zemërimi ynë, ashtu siç bëri Jozefi!

Pyetjet për Diskutim:

A u përpoq Jozefi të hakmerrej ndaj vëllezërve të tij sepse e hodhën në pus dhe e shitën si skllav? Jo! Nuk kërkoi hakmarrje ndaj vëllezërve të tij por i fali ata!
A qau Jozefi sepse ishte i trishtuar apo sepse ishte i lumtur? I lumtur!
Për çfarë i pyeti vëllezërit në vargun 3? A ishte Jakobi babai i tyre ende gjallë?
Cila ishte arsyeja që Jozefi dha se pse ishte atje në vargun 5? Sepse Perëndia e kishte dërguan para tyre për t'i shpëtuar nga zija e bukës! Ai nuk i fajësoi ata ose Perëndinë edhe pas të gjitha gjërave të tmerrshme që i ndodhën Jozefit. Ai qëndroi besnik ndaj Perëndisë dhe e dinte se ishte për shkak të dashurisë së Perëndisë për Jozefin dhe familjen e tij që ata të gjithë përfunduan së bashku dhe të sigurtë në Egjipt!

Falja është çlirimi i dikujt nga borxhi i çfarëdo shkeljeje që kanë kryer ndaj jush. Është heqja dorë nga e drejta për t'u hakmarrë.

Falja:

- **Nuk është minimizimi i asaj që ju është bërë.**
- **Nuk është shmangja e përgjegjësisë. Duhet të jeni të sinqertë lidhur me lëndimin dhe dëmin. Disa herë tregoni dashuri kur lejoni që të përjetojnë pasojat. Dhe mund t'ju thoni se ajo që bënë ju ka lënduar.**
- **Nuk është vendosja e vetes tuaj përsëri në një pozicion kur mund të dëmtoheni përsëri. Nuk keni pse vendosni veten tuaj në një situatë të rrezikshme sepse zgjidhni të falni.**
- **Nuk është harresë e asaj që ndodhi. Por është të qënit të gatshëm të ecni përpara dhe të mos mbani inat për atë ndaj personit që ju lëndoi.**

Kërkoni që nxënësit të dëgjojnë ndërsa ju ose dikush tjetër përfundon së lexuari **Zanafilla 45:16-28.**

Pyetjet për Diskutim:
Cili ishte reagimi i Faraonit? Ai nderoi dhe i dha dhurata dhe tokë familjes së Jozefit për të qëndruar në Egjipt.
Çfarë u tha Jozefi ndërsa po largoheshin nga Egjipti në vargun 24? Mos u grindni!
Pse mendoni se e tha atë Jozefi? Lejoni që nxënësit të përgjigjen.
Jozefi e dinte se kishin një tendencë të grindeshin dhe të inatoseshin. Ai nuk donte që të ziheshin dhe të thoshin gjëra që do të lëndonin njëri-tjetrin.

Kur Jakobi babai i tyre mësoi se Jozefi ishte gjallë, çfarë tha se donte të bënte? Të shkonte Jozefin.

Lejoni për pyetje të tjera përpara sesa të vazhdoni.

3) Fleta e Aktivitetit Jozefi Tregon Veten 15-20 minuta



Jepini fletët e aktivitetit secilit nxënës me një laps dhe krejona. Si klasë lexoni udhëzimet dhe pyetjet me zë të lartë dhe përgjigjuni pyetjeve si klasë. Mund të shkruajnë përgjigjet ose t'i thonë me gojë në varësi të kohës dhe aftësisë së tyre.

Përgjigjet – Faqja 1
1. Kush e vuri re se Jozefi qau? Të gjithë!
Vëllezërit, shërbëtorët dhe shtëpia e Faraonit e dëgjoi të qante.
2. Kush tha Jozefi se e dërgoi atë në Egjipt? Perëndia.
3. Kush tha Jozefi të sillnin në Egjipt? Babanë e tij Jakob dhe të gjithë familjen e tij.
4. Pse tha Jozefi se e solli Perëndia? Për të ruajtur jetën. Për të mbajtur familjen të sigurtë ndaj zisë së bukës.
5. Jozefi i fali vëllezërit e tij, a duhet t'i falim të tjerët? Po!

Nxënësit të shkojnë në Biblat e tyre tek Mateu 6. Le të lexojnë me ju **Mateu 6:14-15.**

Jezusi është duke dhënë një shembull se si të lutemi. Ai thotë se duhet të falim të tjerët dhe të kërkojmë falje kur lutemi.

Mateu 6:14-15
Sepse në qoftë se ju ua falni njerëzve gabimet e tyre, Ati juaj qiellor do t'jua falë edhe juve; por në qoftë se ju nuk ua falni njerëzve gabimet e tyre, as Ati juaj nuk do t'ua falë juve gabimet tuaja.

A duhet të falim të tjerët sipas Jezusit? Po!
Po nëse nuk i falim të tjerët? Perëndia nuk do të na falë të gjitha mëkatet tona!

Mbani mend gjithashtu se gjërat e tmerrshme që i ndodhën Jozefit ishin për t'a ndihmuar atë dhe familjen e tij që të mbroheshin nga zia e bukës në fund të fundit. Nuk do t'a kishin kuptuar në atë kohë, por Jozefi e kuptoi më vonë se pse kishte ndodhur e gjithë kjo. Le të mbajmë mend se disa here gjëra të

këqija ndodhin që të na përgatisin për siguri e mbrojtje dhe është ajo që është më e mira për ne më vonë.

Përgjigjet – Faqja 2
Shenjat e kohës për të falur. Vendosni të gjitha përveç
Kur është ftohtë jashtë, vetëm kur kam dëshirë.

Kush Pati Ndjenjën:
Jozefi kur tregoi veten: Fytyra që Qan dhe/ose e Gëzuar
Vëllezërit e Jozefit kur u tregoi veten: Fytyra e Tronditur dhe/ose e Trishtuar
Jakobi kur dëgjoi se Jozefi ishte gjallë: Fytyra që Gënjen (sepse nuk u besoi atyre) dhe fytyra e Tronditur ose e Gëzuar
Beniamini kur ai dhe Jozefi u përqafuan: Fytyra që Qan dhe/ose fytyra e Lumtur ose e Trishtuar
Faraoni kur dëgjoi rreth familjes së Jozefit: Fytyra e Gëzuar dhe/ose fytyra e Engjëllit/Ndihmuese
Ju kur keni falur dikë: Fytyra e Gëzuar dhe/ose fytyra e Engjëllit/Ndihmuese

Ndryshe nga vëllezërit e tij kur ishin të rinj dhe të këqinj ndaj Jozefit, Jozefi ishte i dashur me ta dhe i fali ata.

4) Opsionale: Vendosni Fashën Tek Plagët 5-10 minuta

Përgatitja
Kini fashat gati për nxënësit.

Aktiviteti
Jepini një ose dy fasha secilit nxënës dhe diskutoni:

Një ide kryesore nga ky mësim është falja. Përse i përdorim fashat? Për të mbrojtur një plagë dhe për të ndihmuar që të shërohet.

Dua që t'i ruani këto fasha për t'ju kujtuar që të ndihmoni të tjerët këtë javë të cilëve u janë lënduar ndjenjat. Jini të mirë me ta, përqafojini nëse është e përshtatshme, ndihmojini ose dëgjojini ndërsa flasin rreth asaj që po i trishton.

Një mënyrë tjetër se si mund t'i përdorni fashat është kur ju jeni lënduar. Jo vetëm fizikisht, por edhe emocionalisht. Edhe pse dikush mund t'ju ketë lënduar – me Perëndinë në jetën tuaj Ai është fasha që na lejon të shërohemi nga lëndimi. Në këtë mënyrë, me ndihmën e Perëndisë mund të shërohemi dhe të falim të tjerët kur na lëndojnë! Dhe mund të ndihmojmë të tjerët kur lëndohen. Mund të mbajmë mend të jemi si Jozefi.

Pse është e rëndsishme të falim dikë që na lëndon? Lejoni që nxënësit të përgjigjen.
Kur është një kohë për të treguar falje për dikë? Lejoni që nxënësit të përgjigjen.
Cila është një mënyrë se si mund të ndihmoni dikë që është lënduar? Lejoni që nxënësit të përgjigjen.

5) Opsional: Eksperimenti Mbajtja e Lëndimeve Tona 5-10 minuta

Kemi mësuar rreth faljes. Por çfarë ndodh kur nuk falim? Ky aktivitet argëtues do të na ndihmojë të mësojmë. Kur nuk falim, e mbajmë zemërimin dhe lëndimin brenda vetes. Nuk ikën. Përkundrazi, shtohet dhe rritet dhe nuk lejon gjëra të mira në jetën tonë sepse jemi tepër të përqëndruar tek gjërat e këqija.

Mbani mend se falja është çlirimi i dikujt nga borxhi i çfarëdo shkeljeje që kanë kryer ndaj jush. Është heqja dorë nga e drejta për t'u hakmarrë. Ne falim sepse ashtu siç mësuam, Bibla na thotë t'a bëjmë këtë. I falim të tjerët në të njëjtën mënyrë që Perëndia është i gatshëm t'ju falë të gjitha mëkatet që bëni.

Le të shikojmë se pse Perëndia thotë se është mirë të falni.

Ndiqni udhëzimet në mënyrë që shpërthimi të mos ndodhë shumë herët.

1. Shtoni ¼ e kupës me ujë të ngrohtë në qesen plastike.
2. Shtoni ½ e kupës me uthull në qese.
3. Vendoseni qesen në tabaka.
4. Merrni një Kleenex dhe vendosni 3 lugë kafeje të sodës së bukës në Kleenex dhe paloseni Kleenex-in rreth sodës së bukës. *Kleenex ngadalëson kohën e reagimit për të siguruar se mund t'a mbyllni qesen.

5. Futeni Kleenex-in e palosur në qese dhe mbylleni plotësisht – bëjeni këtë shpejt dhe sigurohuni se qesja është e mbyllur hermetikisht.
6. Bëni një hap pas dhe kini peshqirat gati nëse është e nevoshme.
7. Nëse reaksioni nuk ndodh menjëherë, tundeni qesen shpejt për të filluar reaksionin kimik.

Pastroni sipas nevojës.

Pra siç mund t'a shikoni, kur nuk falim, emocionet, lëndimet dhe dhimbja jonë thjesht mblidhen brenda vetes tonë derisa shpërthejnë. Prandaj le të falim në mënyrë që të mund të ecim përpara dhe që gjërat e këqija në jetën tonë të mos na kontrollojnë. Por përkundrazi të lejojmë që gjërat e mira, si paqja, falja dhe dashuria të drejtojnë jetët tona ashtu siç thotë Perëndia se duhet të bëjmë dhe mund të bëjmë, edhe pse na ndodhin gjëra të këqija. Le të jemi si Jozefi dhe të falim!

6) Opsionale: E Vërtetë apo E Rreme 5 minuta

Nxënësit të ngrenë dorën nëse shprehja është e vërtetë. Dhe të mos ngrenë dorën nëse shprehja është e rreme.

Kur Jozefi u tha vëllezërve të tij se kush ishte, ata qeshën. Rr.
Jozefi u tha vëllezërve të tij të mos fajësonin vetveten për atë që bënë. V
Jozefi u tha vëllezërve të qëndrojnë në Egjipt dhe që familjet e tyre dhe babai i tij të vinin. Rr
Jozefi dhe Beniamini qanë kur përqafuan njëri-tjetrin. V
Jozefi i dha secilit prej vëllezërve të tij një palë rroba të reja. Rr (Beniamini mori 5)
Jozefi u tha të shkonin në shtëpi dhe se ai do të vinte t'i vizitonte sa herë që të ishte e mundur. Rr
Duhet të fal kur dikush më lëndon ndjenjat e mia. V
Duhet të fal kur dikush më gënjen. V
Duhet të fal kur dikush më bërtet. V
Duhet të fal kur dikush është i keq me mua. V
Duhet të fal kur dikush më merr diçka. V

Kërkojuni nxënësve që me rradhë të mendojnë dhe të thonë një gjë që mbajnë mend nga historia e sotme e Biblës për Jozefin.

7) Lutja e Mbylljes

**Përpara lutjes, pyesni nëse ka ndonjë lutje që nxënësit dëshirojnë të përmendet dhe nëse po, shkruajini për t'i mbajtur mend.

I dashur Perëndi, ju falënderojmë që na tregoni se si të falim të tjerët, pikërisht ashtu siç Jozefi fali vëllezërit e tij. Na ndihmoni të jemi të mirë dhe të heqim dorë nga zemërimi ynë kur lëndohemi. Na ndihmoni të jemi si Jozefi dhe të kemi besim tek Ju. Kur falim të tjerët, na ndihmoni të mbajmë mend t'u themi se për shkak të Perëndisë jemi në gjendje t'i falim ata. Ju lutemi na falni mëkatet tona kur bëjmë gabime dhe na mbani larg tundimeve.

Lutemi për ata në kishë që janë të sëmurë, të dobët ose kanë vështirësi. Le të jenë në gjendje të kthehen tek ne herën e ardhshme. Ju falënderojmë për ndihmën Tuaj, dashurinë Tuaj dhe që jeni Ati ynë. Në emër të Jezusit, Amen.

8) Snack Opsional: Fruta ose Djathë në Formë Zemre 5 minuta

Të gjithë keni bërë një punë të shkëlqyeshme duke mësuar për familjen e Jozefit. Jozefi i fali vëllezërit e tij edhe pse e lënduan shumë. Por ishte më e mira që Jozefi i fali dhe familja u bë më mirë sepse ai e bëri këtë.

Për të na ndihmuar që të mbajmë mend, do të hamë një snack. Jepini secilit nxënës snack. **Çfarë ju kujton kjo formë?** Dashuri, falje, mirësi. **Le të shijojmë snack tonë në formë zemre për të na kujtuar se pse është mirë të falim.**

Çfarë mendoni se ishte pjesa më e mahnitshme për vëllezërit? Fakti se Jozefi ishte gjallë apo fakti se i fali ata?
Cila ishte pjesa juaj e preferuar e mësimit të sotëm?
Kush janë disa njerëz të cilët mund t'i falni?

9) Gjëra për të Mbajtur Mend

Falënderoni nxënësit për ardhjen e tyre.
Nxënësit t'i marrin fletët e aktiviteteve me vete.
Sigurohuni që nxënësit të largohen me një person përgjegjës.
Faleminderit që i shërbeni Krishtit në këtë mënyrë!